

Koleksionohet specia e elbit me qepujkë (*Hordeum Bulbosum* L.)

Elbi me qepujkë (*Hordeum Bulbosum* L.) është një formë e egër e elbit e cila është në listën e IUCN të **specieve të rrezikuara** pasi ndryshimet klimatike dhe ndikimit njerëzor ka bërë që ajo të jetë përfshirë në këtë listë dhe të gëzojë një status të veçantë mbrojtjeje. Kjo formë e egër e elbit është identifikuar nëpërmjet ekspeditave eksploruese dhe në vendin tonë.

Në **Shqipëri janë zhvilluar ekspedita koleksionimi** ndër vite nga autore shqiptar dhe të huaj. Së fundmi nga një eksplorim i zonave të Shqipërisë së Jugut, dhe konkretisht në kodrat e fshatit Dritas të komunës Finiq, Sarandë, janë identifikuar dhe janë marrë edhe mostra të tyre për tu **rigjeneruar dhe ruajtur në bankën gjenetike të bimëve të Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve.**

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar mostra të këtij elbi janë dërguar edhe në IPK (Institutin i Gaterslebenit në Gjermani), me qëllim kryerjen e analizave gjenetike dhe plotësimin e pasaportës së tij.

Elbi me qepujkë është një formë e egër por e përshtatur mjaft mirë me kushtet klimatike të vendit tonë dhe për këtë arsye studimi i sajë dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen janë të domosdoshme. Specia është konsideruar dhe vazhdon të mbetet i tillë si një material gjenetik me vlera për institucionet kërkimore në programet e përmirësimit gjenetik të drithërave dhe veçanërisht të Elbit.

Në kushtet e ndryshimeve klimatike dhe të ndikimit që ato kanë mbi format e kultivuara të bimëve të arave, ruajtja dhe përdorimi i **Elbit me qepujkë** merr një rëndësi të veçantë. Ka shumë iniciativa dhe programe të përmirësimit gjenetik për të shfrytëzuar gjenet dhe aftësinë që ka elbi me qepujkë në programet e përmirësimit tek drithërat për të transmetuar këto gene dhe këto aftësi të përshtatjes dhe të garantimit të prodhimeve të qëndrueshme në kushtet e këtyre impakteve klimatike.

Elbi me qepujkë ka gjithashtu vlera dhe aftësi të rezistencës dhe qëndrueshmërisë ndaj sëmundjeve të drithërave të cilat shkaktojnë dëme të mëdha të prodhimit bujqësor. Edhe këto gjene dhe aftësi të rezistencës ndaj sëmundjeve të drithërave janë pjesë e programeve të përmirësimit gjenetik nga shumë institucione kërkimore në Evropë dhe më gjerë.

Kjo specie është evidentuar dhe gjetur edhe në vende të tjerë të rajonit të Mesdheut kryesisht, në Evropën Juglindore, Jugperëndimore dhe Lindore si dhe në Lindjen e Mesme, Azi, Kaukaz, në Afrikën e Veriut dhe në Amerikën e Jugut, por format dhe habitatet në të cilat janë përshtatur këto forma janë specifike dhe me vlera të veçanta për Shqipërinë.



- Elbi me qepujkë ka një lartësi trupore nga 50-100 cm lartësi.
- Gjethet e elbit kanë një gjatësi 10-15 cm dhe një gjerësi 3-7 mm.
- Kalliri i elbit ka një gjatësi 6-13 cm dhe një gjerësi prej 6-10mm.

Prof.Dr. Pellumb Abeshi,
Institutit i Resurseve Gjenetike të Bimëve
Universiteti Bujqësor i Tiranës,